

VAKSINIME PËR TË GJITHË

Vaksinat përforcuese kundër COVID-19 Pyetje të shpeshta

Injekzioni përforcues kundër COVID-19 rekomandohet për cilindo nga 5 vjeç e lart që ka bërë dozën e dytë të vaksinave të Pfizer ose të Moderna pesë a më shumë muaj më parë, ose që ka bërë dozën njëshe të vaksinës së Johnson & Johnson (J&J) dy a më shumë muaj më parë.

Çfarë është vaksina përforcuese?

Vaksina përforcuese është një dozë shtesë e një vaksine pas kryerjes së një serie vaksinash dhe përdoret për të përforcuar imunitetin kundër virusit pasi mbrojtja mund të ketë rënë me kalimin e kohës (ky quhet imunitet në rënje).

Kush mund ta bëjë vaksinën përforcuese?

5 muaj pas bërjes së dozës së dytë të vaksinave të Pfizer ose të Moderna, gjithkush nga 5 vjeç e lart duhet të bëjë një injekzion përforcues.

2 a më shumë muaj pas bërjes së vaksinës njëshe të J&J, cilio nga 18 vjeç e lart duhet të bëjë një injekzion përforcues.

Përse rekomandohet vaksina përforcuese?

Vaksinat kundër COVID-19 janë ende shumë efikase në parandalimin e sëmundjeve të rënda, shtrimit në spital dhe vdekjes për shkak të COVID-19. Por ka studime që tregojnë se mbrojtja ndaj infektimit e ofruar nga vaksinat e Pfizer dhe të Moderna mund të fillojë të bjerë pas rreth 5 muajve ose pas rreth 2

muajve nga vaksina e J&J. Vaksina përforcuese mund të ofrojë mbrojtje të mëtejshme për personat që janë në rrezik të shtuar ekspozimi ndaj COVID-19 ose sëmundjeje të rëndë COVID-19.

Çfarë problemesh mjekësore e rrisin rrezikun për sëmundje të rënduar të COVID-19?

Problemet mjekësore që rrisin rrezikun e COVID-19 të rënduar përfshijnë diabetin, problemet e zemrës, sëmundjen kronike të veshkave, sëmundjen kronike të mushkërive, sëmundjen e mëlcisë, kancerin, demencën, HIV dhe shtatzëninë. Për një listë të plotë, shikon:

[cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/need-extraprecautions/people-with-medical-conditions.html](https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/need-extraprecautions/people-with-medical-conditions.html)

Kush është në rrezik të shtuar ekspozimi ndaj COVID-19 në ambientin e punës apo ambiente të tjera?

Punët që mund të shtojnë rrezikun e ekspozimit ndaj COVID-19 përfshijnë punonjësit shëndetësorë, mësuesit, personelin e kujdesit ditor dhe punonjësit e restoranteve dhe të ushqimoreve. Ambiente të tjera ku mund të ketë rrezik të shtuar ekspozimi përfshijnë qendrat për të pastrehët dhe burgjet.

Si ta kuptoj nëse kam nevojë për vaksinë përforcuese?

Flisni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor nëse keni pyetje për bërjen e vaksinës përforcuese. Nëse keni nevojë për ndihmë për të gjetur një ofrues, telefononi në nr. 311 ose në nr. 212-COVID-19 (212-268-4319) dhe flisni me një infermier për të mësuar nëse kualifikoheni.

A mund ta bëjnë përforcuesen gratë shtatzëna, që ushqeijnë me gji ose që planifikojnë të mbeten shtatzëna?

Gratë që janë aktualisht apo kanë qenë së fundi shtatzëna kanë rrezik të shtuar që të pësojnë sëmundje të rënda nga COVID-19 në krasim me joshtatzënët. Shtatzënët duhet të vaksinohen kundër COVID-19. Nëse shtatzënët i plotësojnë kriteret kualifikuese, duhet të bëjnë vaksinë përforcuese.

Cilat janë rreziqet që vijnë nga bërrja e vaksinës përforcuese?

Për shumë njerëz që kanë bërë dy dozat e vaksinave të Pfizer ose Moderna, ose vaksinën njëdozëshe të J&J, përfitimet nga bërrja e vaksinës përforcuese i tejkalojnë rreziqet e mundshme. Deri më tanë reaktionet e raportuara pas bërrjes së vaksinës përforcuese kanë qenë të njëjtë me ato pas dozave fillestare. Lodhja dhe dhimbja në krah kanë qenë efektet më të raportuara anësore. Shumica e efekteve anësore kanë qenë të buta deri në mesatare.

A është vaksina përforcuese e njëjta vaksinë si dy dozat e para?

Po. Vaksina përforcuese është e njëjta vaksinë si secila nga dy dozat e para të Pfizer ose Moderna, ose doza njëshe e J&J. Por doza përforcuese e Moderna është dy herë më e madhe se dy dozat e para të administruara.

A është e nevojshme që marka e vaksinës sime përforcuese të jetë e njëjtë me të vaksinës së parë që bëj?

Të vaksinuarit duhet të përpilen të bëjnë si përforcuese të njëjtën vaksinë që kanë bërë fillimisht, por kanë zgjedhjen ta ndërrojnë me cilëndo nga dy llojet e tjera të vaksinave.

Kur duhet ta bëj vaksinën përforcuese?

Nëse jeni 5 vjeç e lart duhet të bëni një injekcion përforcues 5 muaj pasi të keni bërë dozën e dytë të vaksinave të Pfizer ose të Moderna. Nëse jeni 18 vjeç e lart dhe keni bërë dozën njëshe të vaksinës së J&J duhet të bëni një injekcion përforcues 2 muaj pas dozës suaj fillestare.

Nëse na duhet një vaksinë përforcuese, a do të thotë kjo që vaksinat nuk po bëjnë punë?

Jo. Vaksinat kundër COVID-19 po funksionojnë mirë për të parandaluar sëmundjen e rëndë, shtrimin në spital dhe vdekjen. Megjithatë ekspertët e shëndetit publik kanë filluar të shohin rënien të lehta në mbrojtje, sidomos mes popullatash të caktuara.

Ku mund ta bëj vaksinën falas?

Vaksinat përforcuese të Pfizer dhe të J&J ofrohen në të 11 spitalet e sistemit të NYC Health + Hospitals. Vaksinat përforcuese të Moderna ofrohen në cilëndo qendër të NYC Health + Hospitals/Gotham Health. Nuk ka nevojë të shkoni në të njëjtën qendër ku keni bërë dy dozat e para të vaksinës së Pfizer apo të Moderna, apo vaksinën njëdozëshe të J&J. Paraqituni në cilindo spital kujdesi të shpejtë të NYC Health + Hospitals apo qendër të NYC Health + Hospitals/Gotham Health për vaksinën përforcuese ose telefononi në nr. 1-877-829-4692 për ndihmë në shumë gjuhë.

A mund ta bëj vaksinën përforcuese njëherësh me vaksina të tjera (si p.sh. vaksinën kundër gripit)?

Po. Bërrja e vaksinës përforcuese njëherësh apo në çfarëdo kohe para apo pas vaksinave të tjera është e sigurt. Nëse nuk e keni bërë ende vaksinën kundër gripit, të dyja ofrohen në qendrat spitalore të kujdesit të shpejtë të NYC Health + Hospitals.

A më duhet vaksina përforcuese për t'u vaksinuar plotësisht?

Jo. Njerëzit konsiderohen plotësisht të vaksinuar dy javë pas dozës së dytë të një vaksine dydozëshe (si p.sh. Pfizer ose Moderna) ose dy javë pas vaksinës njëdozëshe të J&J.

A do të bëhen me detyrim ligjor vaksinat përforcuese?

Detyrimi ligjor për vaksinim i shtetit të Nju-Jorkut për punonjësit e kujdesit shëndetësor vlen vetëm për dozat e para dhe të dyta. Detyrimi ligjor nuk përfshin vaksinat përforcuese.

A rekomandohen vaksinat përforcuese për fëmijët?

Për momentin të gjithë personat 5 vjeç e lart inkurajohen të bëjnë një injekzion përforcues. Personat 5-17 vjeç që kanë bërë më parë serinë primare të Pfizer mbi 5 muaj më parë përfitojnë vetëm injekzionin përforcues të Pfizer. Fëmijë të caktuar me imunitet të cenuar të moshës 5-11 vjeç mund të bëjnë një dozë shtesë të vaksinës së Pfizer 28 ditë pas injekzionit të dytë.

